

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
GARDA E REPUBLIKËS**



STRATEGJIA

E

GARDËS SË REPUBLIKËS

2020-2030

PASQYRA E LËNDËS

Hyrje	3
Kapitulli I	
Vlerësimi i arritjeve të Gardës së Republikës në pesë vitet e fundit	4
Kapitulli II	
Vlerat, vizioni dhe misioni I Gardës së Republikës	9
Kapitulli III	
Prioritetet dhe objektivat strategjikë	10
Kapitulli IV	
Buxheti	21
Kapitulli V	
Zbatimi dhe monitorimi	23

Hyrje

Strategjia e Gardës së Republikës 2020-2030 është një dokument që paraqet vizionin tonë për zhvillimin e Institucionit. Ai është hartuar mbi bazën e legjislacionit të brendshëm, Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, dokumenteve të tjera programuese, si dhe analizave e studimeve mbi shërbimin e sigurisë së personaliteteve dhe objekteve në ruajtje. Në të ndërthuren ide strategjike të bazuara në përbushjen e misionit të Gardës, për të realizuar përafrimin e saj me institucionet homologe. Me zbatimin e kësaj strategjie synohet të përmirësohet dukshëm dhe të rritet efektiviteti i punës së Gardës së Republikës. Strategjia është në vazhdim të përmirësimeve të ndryshme të ndodhura vitet e fundit në Gardë dhe njëkohësisht me objektivin e qartë të ndryshimeve edhe më të rëndësishme që priten të ndodhin pas përbushjes së pikës më strategjike të dokumentit që ka të bëjë me miratimin e ligjit të ri “Për Gardën e Republikës”. Kjo strategji përmban drejtimin e qartë dhe vizionin e strukturave tona të sigurisë për modernizimin e Gardës, përmirësimin e infrastrukturës ligjore të institucionit, rritjen e kulturës dhe profesionalizmit; përmirësimin e kushteve të punës, futjen e teknologjive në rritjen e sigurisë së objekteve. Ky dokument ka në themel bashkëpunimin dhe koordinimin e integruar të detyrave, si brenda strukturave të Gardës ashtu edhe ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit. Strategjia dhe plani i veprimit konkret parashikojnë përmirësim të vazhdueshëm financiar për punonjësit e Gardës, veçanërisht të atyre të nivelit bazë, përmirësim të sigurisë dhe kujdes për mirëqenien e punonjësit për të motivuar dhe rritur dinjitetin e tij. Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga ky dokument dhe planet e veprimit dhjetëvjeçar, do të shoqërohen me një planifikim të detajuar nga të gjitha strukturat e Gardës, si dhe me përgjegjësi për zbatimin e monitorimin e realizimit të tyre.

Kjo strategji është vazhdim i aplikimit të Strategjisë 2019-2020 dhe hartohet duke rivlerësuar arritjet e deritanishme. Strategjia e re do të synojë të përmirësojë disa politika të cilat nuk rezultuan të suksesshme ose rezultuan të pamjaftueshme për të sjellë një ndryshim më cilësor të shërbimeve.

Dokumenti i Strategjisë së Gardës së Republikës 2020 -2030 në prioritetet e veta synon të trajtojë:

- Analizë cilësore të arritjeve të deritanishme
- Objektivat strategjike për 2020-2030
- Plan-veprimi për Strategjinë e Gardës së Republikës 2020-2030
- Pritshmëritë e Gardës së Republikës për 2020-2030

KAPITULLI I

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS NË PESË VITET E FUNDIT

I. Vlerësim i përgjithshëm

Prioriteti kryesor gjatë këtij pesë vjeçari për Gardën e Republikës ka qenë përmbushja e misionit të saj. Më gjerësisht përfshihet; siguria e jetës së personaliteteve, e objekteve dhe mjediseve të punës, të banimit, të akomodimit, sigurisë së rrugëkalimeve, siguria e personaliteteve në shërbime të hapura e të mbyllura me qëllim që të prandalohet në kohë jo vetëm çdo akt i mundshëm me tendenca kriminale, por edhe çdo veprim tjetër sado i dhunshëm apo pengues në lëvizjen normale dhe ushtrimin e detyrës së personalitetit.

Të bësh bilancin e këtyre viteve, padyshim është një çështje që kërkon vëmendjen e duhur për të analizuar të gjithë komponentët përbërës të punës sonë, me treguesit pozitivë, por edhe problematikat e hasura. Ky vlerësim që bëhet në këtë kapitull, pasqyron në mënyrë të përmbledhur këta tregues për secilën strukturë përbërëse të saj, e cila ka specifika të vetat në detyrat që kryen.

Arritjet dhe problematikat e konstatuara gjatë punës pasqyrojnë sfidat, me të cilat jemi përballur gjatë kësaj kohe. Në punën tonë ne jemi mbështetur në zbatimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies e meritokracisë.

Për të patur sukses është shumë e rëndësishme organizimi i punës dhe shpërndarja e saj. Përpos kryerjes së misionit dhe zbatimit në mënyrë rigorozë të ligjit, qëllim për ne përbën edhe përfaqësimi sa më natyrshëm, real dhe me dinjitet i punonjësit të këtij shërbimi në komunitet si pjesë përbërëse e tij, krijimi i emrit të respektuar të Institucionit si pjesë e administratës shtetërore dhe përfaqësimi dinjitoz i imazhit të Shqipërisë tek Personalitetet e Huaja.

II. Vlerësimi i komponentëve

Duke qenë se misioni i Gardës dhe vetë objekti i punës lidhen ngushtësisht me sigurinë e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje, edhe vlerësimi i punës së Gardës nis me cilësinë e përmbushjes së këtyre detyrave që rrjedhin nga misioni i përgjithshëm.

Këto vite kanë patur të veçantat e veta në aspektin e objektivave e prioriteteve, për ngarkesën e konsiderueshme që i ka karakterizuar dhe performancën cilësore të realizimit të shërbimeve, veçanërisht të atyre të kryera mbi kohën normale të punës.

Strukturat operacionale

Duke qenë se detyrat kryesore të Gardës lidhen drejtpërdrejt me shërbimet operacionale, ato nisin që në krye të çdo viti me hartimin e planit të veprimtarive dhe metodologjisë së përdoruar për zbatimin e tyre.

Për realizimin e programeve përcaktohen dhe merren një sërë masash. Disa nga më kryesoret:

- Mbështetja e plotë me akte normative për Sigurinë e PLSH-ve, PSH-ve, ORV-ve, objekteve të infrastrukturës së Gardës si dhe me akte të brendshme.
- Përmirësimi i planifikimit të detyrave në mënyrë të tillë që të ishte sa më real.
- Marrja e masave parandaluese të akteve kriminale ndaj PLSH-ve, PSH-ve, ORV-ve, me në fokus parandalimin e akteve terroriste.
- Drejtimi me kompetencë dhe menaxhimi me efikasitet i kohës së punës nga Drejtuesit e strukturave dhe kontrolli real i elementëve të sigurisë.
- Administrimi i fondeve me planifikim, menaxhim e realizim të plotë në funksion të rritjes cilësore të shërbimeve të sigurisë.
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me struktura të tjera ligjzbatuese.

Trajtimi financiar i punonjësve, investimet dhe Buxheti

- Miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.638, datë 29.07.2020 "Për trajtimin me ushqim pa pagesë, të punonjësve dhe kursantëve të Gardës së Republikës", i jep trajtimin me ushqim punonjësve të Gardës që kishte munguar gjithë këto vite. Miratimi i kësaj VKM-je i jep një hov cilësor shërbimit të sigurisë.
- Miratimi i VKM nr.640, datë 29.7.2020 "Për një ndryshim në VKM nr.551, datë 15.7.2020 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve oficerë dhe nënoficerë të Gardës së Republikës së Shqipërisë" sjell rritje të trajtimit financiar deri në masën 10% dhe vlerësim të tyre. Rritja është e një vlere të konsiderueshme që s kishte ndodhur që prej shumë vitesh. Që prej vitit 2013 punonjësit përfituan një rritje page prej afro 15%.
- Miratimi i VKM nr.639, datë 29.7.2020 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve oficerë dhe nënoficerë të Gardës së Republikës së Shqipërisë" çdo punonjës Garde përfiton një rritje në pagë në masën 1 % për çdo vit pune.
- Sa i përket sektorit të transportit janë rinovuar 2 herë eskortat e PLSH-ve duke u përshtatur në bazën ligjore "Çdo 5 vjet dhe/ose 50000 km" si dhe janë rinovuar mjetet në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve. Që prej vitit 2019 funksionojnë sisteme të kohës (GPS) për menaxhimin e mjeteve të transportit me qëllim rritjen e sigurisë së personaliteteve dhe njëkohësisht implementimin e metodave bashkëkohore për kontrollin e lëvizjeve të automjeteve për të shmangur çdo abuzim të mundshëm. Është krijuar një sistem online monitorimi 24 orësh i menaxhuar nga Salla Operative e Gardës.
- Ndërtim zyrash dhe ambientesh pune në Komandën e Gardës me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për punë në harmonizim me modelet e zyrave të çdo administrate dhe

formimin e një imazhi të denjë të institucionit për tu vizituar nga personalitete, ateshe ushtarakë, ambasadorë etj.

- Garda e Republikës gjatë këtyre viteve është e kompletuar me armatim brezi në **masën 100%**. Me armatim automatik për vitin 2020 në **masën e kompletimit prej 40%**.

Modernizimi i teknologjisë

Kemi **zhvilluar sistemin e komunikimit dhe elektronikës** duke synuar rritjen e sigurisë dhe përafrimin e shërbimit me atë ndërkombëtar dhe modern. Ndër ndryshimet e rëndësishme dhe që vlen të përmenden janë:

- Kalim në sistemin digjital në masën 100%.
- Ndërtimi dhe zhvillimi i Qendrës së Komunikimit Mobil me elementë si: Sistemi i Radio komunikimit, Ndërlidhja Satelitore, pajisja me Sistemin e Bllokimit të Valëve Celulare, pajisja me Sistemin Anti Drone.
- Mbështetja në Serverat e Gardës e Faqes Zyrtare të Gardës së Republikës, që ishte jashtë funksionit deri në vitin 2013.

Hapjen e adresave Zyrtare për Personelin e Gardës dhe menaxhimin e sigurtë të informacionit në servera.

Infrastruktura ligjore

Gjatë këtyre viteve të fundit janë bërë përpjekje të vazhdueshme për miratimin e projekt-ligjit “Për Gardën e Republikës”.

Në zbatim të detyrës që sanksionohej herëpashere në programet e Ministrisë së Brendshme për zbatim nga Garda, por edhe si pasojë e nevojës së Institucionit për përmirësimin e infrastrukturës ligjore, në vitin 2018 u përgatit në kohë projektligji “Për Gardën e Republikës”. Miratimi i projektligjit parashikohet si një objektiv strategjik i cili do të sjellë risi, pasi do të hapë rrugën e reformimit të infrastrukturës ligjore, strukturore, formuese, kualifikuese, përmirësim të burimeve njerëzore, të përparimit në gradë dhe ecurisë në karrierë, trajtimit financiar, etj.

Ndër dokumentet më të rëndësishme të miratuara për përmirësimin e funksionimit të Gadës mund të përmenden; hartimi dhe miratimi i manualeve të përshkrimit të detyrave funksionale, të cilat u panë si të domosdoshmëm në mbarëvatjen e punës së përditshme dhe ndarjen e qartë të përgjegjësive për çdo funksion, hartimi dhe miratimi i Manualit të Etikës për punonjësin e Gardës me qëllim rritjen e performances dhe përmirësimin e komunikimit me etikë të punonjësit, Programi i modernizimit të strukturave të Gardës, Rregullorja e Procesit të Konkurimit për Gradë.

Burimet Njerëzore

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është thelbësor për Gardën e Republikës sepse nënkupton përdorimin e drejtë dhe eficient të njerëzve për të kryer misionin e Institucionit. Është shumë e

rëndësishme që punonjësit e sigurisë të kenë integritet të lartë, të jenë të besueshëm, korrekt, të përgjegjshëm dhe të kryejnë me devotshmëri çdo detyrë. Eksperienca ka treguar se përgatitja e burimeve njerëzore, që fillojnë punën rishtazi, por edhe përmirësimi i nivelit të përgatitjes së burimeve njerëzore ekzistuese përbëjnë aset por njëkohësisht edhe hallkë të dobët të institucionit në rast se nuk i kushtohet vëmendja e duhur. Procesi i menaxhimit të burimeve njerëzore fillon që në fazën e rekrutimit të individëve, proces gjatë të cilit Garda zgjedh punonjësit e saj, duke u bazuar në aftësitë dhe përgatitjen e kandidatëve e duke vazhduar zhvillimin e tyre me anë të trajnimit. Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore ka të bëjë me përmirësimin e aftësive të individëve, me qëllim realizimin sa më eficient të detyrave të secilit. Duke qenë një nga Sektorët më të rëndësishëm të Institucionit tonë, vëmendja maksimale i është kushtuar resurseve të këtij Sektori.

Veçojmë si arritje për këtë sektor edhe përgatitjen e Rregullores së funksionimit dhe organizimit të komisionit të gradave në Gardë, të hartuar në vitin 2019.

Përparësi i është dhënë uljes së moshës mesatare në sektorë të rëndësishëm si në atë të Drejtorisë për sigurinë e PLSH-ve, kryesisht në Shërbimet e sigurisë së PLSH-ve dhe në Sektorin e shërbimeve të sigurisë së Delegacioneve, si dhe në Njësinë speciale.

Në vitin 2020 u miratua struktura e Gardës së Republikës për përshtatjen e dinamikave të reja të punës, që lidheshin kryesisht me marrjen e përgjegjësisë të reja, siç ishin ruajtja dhe mbrojtja e organeve të reja të drejtësisë. Ndryshimet e bëra në strukturën e re janë frut i një pune dhe studimi të nevojave për përmirësime që do të rrisnin efektivitetin e strukturave dhe shërbimeve. Është punuar në vijimësi për kompletimin organik të strukturës në interes të plotësimit të detyrës duke synuar masën 100%. Është punuar për kompletimin e strukturave sipas prioriteteve dhe ngarkesës së punës, me qëllim përmbushjen e detyrave prej tyre, pa krijuar probleme.

Kuotat për femra në strukturat tona janë disi të kufizuara sepse rreth 80% e shërbimeve janë me tre turne ose me orare të zgjatura. Pavarësisht dinamikës së vështirë të punës në strukturat e Gardës është rritur numri i të punësuarve femra duke synuar përafrimin e qasjes së qeverisë shqiptare për barazimin e kuotave gjinore.

Kërkesa e vazhdueshme për përmirësimin e nivelit arsimor të të rekrutuarve ka bërë që aktualisht 100% e efektivit oficer të jenë me arsim të lartë, 25% e të cilëve edhe me studime pasuniversitare apo trajnime për nivele të larta në hierarkinë ushtarake apo fusha të tjera, 100% e punonjësve nënoficerë janë me arsim të mesëm dhe 24 % e tyre kanë edhe arsimin e lartë në fusha të ndryshme. Afrimi i kandidatëve me arsim të lartë ka rritur nivelin intelektual të të punësuarve, duke sjellë edhe rritje të nivelit të qytetarisë në komunikim gjatë kryerjes së detyrave.

Më konkretisht gjendja e arsimimit të punonjësve të Gardës, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Of. me Arsim Ushtarak	Of. me Arsim Policor	Of. me Arsim Civil dhe ushtarak	N/of me arsim të Mesëm	N/of me arsim të Lartë
-----------------------	----------------------	---------------------------------	------------------------	------------------------

205	77	80	1081	247
-----	----	----	------	-----

Me punonjësit aktual është ndjekur një politikë nxitëse për vazhdimin e studimit në fushat përkatëse apo në disa funksione drejtuese edhe për shkollim në drejtime të tilla si menaxhim të burimeve njerëzore apo drejtim dhe administrim. Për disa funksione pune kemi rritur në perspektivë kërkesat për konkurrim për pozicionin e punës, si psh në vitin 2025, juristët duhet të kenë përfunduar studime master në drejtësi apo fusha të përafërta që të rikonfirmohen në funksion. Po kështu sipas pozicionit të punës, të kenë përfunduar studime master për IT, financën dhe disa sektorë të logjistikës.

Heqja nga terminologjia e emërtimeve tërësisht ushtarake, mendojmë se e afron këtë organizëm më shumë me administratën publike dhe me përvojat e shërbimeve homologe të vendeve të zhvilluara, pa cënuar rolin dhe misionin që ka Garda.

Sistemi i vlerësimit periodik dhe vjetor i është nënshtruar një procesi të mirëkonceptuar dhe me tregues real dhe të matshëm. Vlerësimi vjetor dhe ai periodik në strukturat e Gardës së Republikës bëhet bazuar në tregues të performancës, integritetit dhe përgatitjes profesionale të punonjësve. Modelet e vlerësimit kanë pësuar ndryshime në vite duke ju përgjigjur kërkesave të kohës. Modeli aktual i formularit të vlerësimit është hartuar duke u konsultuar me përvojat më të mira të shërbimeve homologe në vendet e zhvilluara. Vlerësimi i punonjësit bëhet nga drejtuesi i tij më i afërt dhe falë mekanizmave të ndërtuar për këtë qëllim, mendojmë se është arritur, duke pasqyruar vlerësim sa më afër realitetit. Sektori i Burimeve Njerëzore ka një evidentim të saktë të vlerësimeve vjetore edhe elektronikisht, dhe çdo punonjës merr njoftim e shpreh mendimin e tij për vlerësimin që i është bërë. Kjo ka shërbyer edhe për të bërë një parashikim për ecurin në gradë e karrierë për secilin.

Aktualisht të gjithë punonjësit e Gardës së Republikës, i nënshtrohen vlerësimit vjetor, i cili përfshin edhe testimin profesional dhe fizik që bëhen pjesë e dosjes dhe e praktikës së ecurisë në gradë e karrierë të secilit.

Trajnimet

Kualifikimet dhe trajnimet e punonjësve janë pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së Gardës, pasi mundësojnë rritjen e aftësive profesionale dhe zhvillimin e dijeve. Me qëllim krijimin e një sistemi të plotë trajnimi bashkëkohor i cili t'i përshtatet nevojave dhe kërkesave të Gardës, punohet në tre drejtime strategjike:

- Unifikimi i trajnimeve të realizuara.
- Identifikimi i nevojave të Gardës për trajnime.
- Përpilimi dhe miratimi i moduleve për çdo trajnim.

U rikonceptua metodologjia e arsimimit dhe trajnimit në vazhdimësi duke ndjekur strategjitë e mëposhtme:

- **Marrëveshje e përbashkët** me Akademinë e sigurisë për arsimimin dhe kualifikimin e punonjësve me grada të larta
- **Marrëveshje e përbashkët** me Akademinë e sigurisë për kualifikimin e punonjësve të Gardës së Republikës me arsim të lartë jopolicor.
- **Me Akademinë e Sigurisë kemi hartuar programe të përbashkëta**, në përputhje me nevojat që kemi dhe në periudhën raportuese janë trajnuar në kurse 2 mujore 80% e oficerëve me arsim të lartë jo policor dhe rreth 30% e nënoficerëve që kanë mbaruar arsimin e lartë, kanë marrë njohuri policore në këto kurse.

KAPITULLI II

VLERAT, VIZIONI DHE MISIONI I GARDËS SË REPUBLIKËS

Vlerat

Strategjia e Gardës së Republikës, vlerëson maksimalisht dhe mbështetet në:

- Vlerat më të mira kulturore e historike të popullit shqiptar, të trashëguara në vite dhe aspirimin e tij për të qenë pjesë e familjes së madhe europiane;

- Vlerat e institucionit të Gardës së Republikës dhe të punonjësve të saj, të shprehura në legjislacionin e saj, aktet e brendshme normative; himnin, flamurin, simbolet dhe titujt e saj;
- Gatishmërinë për të bashkëpunuar;
- Cilësitë e krijuara të ndershmërisë, besueshmërinë, të përkushtimit dhe integritetin në detyrë;
- Traditat dhe aktet heroike të punonjësve në mbrojtje të ligjit dhe të qytetarëve;
- Arritjet e veprimtarisë së përditshme për mbrojtjen e përfaqësuesve të shtetit dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, si dhe eksperiencën profesionale të grumbulluar etj.

Detyrat e vështira për përmbushjen e misionit nuk mund të përballohen nga punonjësit e Gardës sado të zotë qofshin, nëse ata nuk mbartin si individë vlerat dhe cilësitë më të mira morale e profesionale. Është përgjegjësi e drejtuesve të Gardës në çdo nivel, për t'ju rikthyer çështjes së vlerave në radhët e Gardës duke i kushtuar një vëmendje të veçantë integritetit të secilit dhe gjithashtu motivimit të tyre në kryerjen e detyrave.

Vizioni

Vizioni i Gardës është “Garantimi i një mjedisi të sigurt për Personalitetet e Larta Shtetërore dhe objekteve e ambienteve të tjera nga shërbimi i sigurisë, me standardet më të larta të performancës, krijimit të një kulture bashkëkohore manaxhimi dhe të mbështetur me infrastrukturën më të përparuar” i cili është i lidhur ngushtësisht me zbatimin në mënyrën më korrekte të ligjit, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të punës për të arritur atë që kërkohet.

Bazuar në vlerat e shoqërisë shqiptare dhe në vlerat e punonjësve të saj, Garda e Republikës do të punojë me përkushtim për të siguruar personalitetet dhe objektet në ruajtje si rrjedhojë duke i ardhë në ndihmë edhe sigurisë kombëtare, njëherësh për t’u siguruar punonjësve të vet trajtim të njëjlojtë, kualifikim, mbrojtje dhe karrierë të suksesshme. Përmbushja e vizionit shtron nevojën e vendosjes së standardeve për komunikimin, transparencën e llogaridhënien në rendin hierarkik. Motoja e Gardës së Republikës është: “*Së bashku për një siguri më të garantuar*”.

Misioni

Misioni i Gardës së Republikës është: “*ruajtja dhe mbrojtja e personaliteteve të larta shtetërore dhe të rezidencave, të përcaktuara me ligj,,* Zhvillimi në rritje i Gardës do të na çojë drejt realizimit të misionit të saj ligjor. Të gjithë punonjësit e Gardës do të kenë të qartë misionin, përgjegjësitë e kompetencat dhe do t’u përgjigjen atyre në veprimtarinë e përditshme sipas ligjit, në të kundërt, ata kanë shkelur atë dhe betimin e bërë për mbrojtjen e ligjit.

Ndryshimet e realizuara gjatë zhvillimit të reformave, për shkak të traditës janë shoqëruar me ndjenjën e euforisë, të cilat kanë çuar në tendencën e mbylljes, ruajtjes së gjendjes dhe deri vetëkënaqësisë. Për zhvillimin e saj dhe të modelit të denjë të punonjësit të Gardës, në të ardhmen do të punohet për të kaluar nga sistemi i mbyllur e i pandryshueshëm në atë të hapur, dinamik dhe elastik që mund t’i përshtatet mjedisit.

KAPITULLI III

PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Prioritetet e Gardës së Republikës për 2020-2030 janë :

- Përmirësimi i nivelit të sigurisë së personaliteteve dhe objekteve në ruajtje
- Ndërtimi i infrastrukturës ligjore për përafrimin e Gardës së Republikës me strukturat homologe

- Përmirësimi i politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore
- Krijimi i një kulture moderne menaxhimi

I. PËRMIRËSIMI I NIVELIT TË SIGURISË SË PERSONALITETEVE DHE OBJEKTEVE NË RUAJTJE

Përmirësimi i procesve të punës të strukturave operationale shpërndahet në nivel Drejtorie, Njësie, Sektori.

Garda e Republikës së Shqipërisë është e vetëdijshme për identifikimin e kërkesave që shtrohen në lidhje me detyrat që ajo kryen. Ajo në vazhdimësi është fokusuar tek përmirësimi i cilësisë së shërbimit. Kjo ndjeshmëri vjen si rezultat i krijimit të një vizioni të ri për institucionin tonë.

Strukturat e sigurisë së afërt të personaliteteve, nga ana e rrezikut dhe të përgjegjësisë, rreshtohen ndër të parat në raport me strukturat e tjera, për rrjedhojë dhe marrja e masave organizative dhe teknike në këtë proces së pari është detyrë dhe përgjegjësi ligjore e këtij shërbimi.

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të këtyre strukturave duke demonstruar organizim, dinamizëm, profesionalizëm, shkathtësi, korrektësi, bashkëpunim e bashkërendim, ndihet si një nevojë dhe mbetet element i rëndësishëm për tu përmirësuar e deri në perfeksionuar për performancën e shërbimeve operationale.

Shërbimet operationale (*trupshërbimi*) dhe përgjegjësat e tyre duhet të jenë vazhdimisht në kërkim të mjeteve të cilat synojnë rritjen e vlerësimit të shërbimit tek Personaliteti që siguron, sikurse edhe tek publiku.

Fusha ku duhet fokusuar më tepër vëmendja është krijimi i marrëdhënieve institucionale dhe tepër korrekte me personalitetin, punonjësit e administratës dhe me qytetarët, pasi të gjitha këto janë ndikues të drejtpërdrejtë në imazhin e Gardës.

Përpjekjet duhet të orientohen drejt rritjes së profesionalizmit, vigjilencës së lartë për të bërë të mundur parandalimin e çdo tentative për të dëmtuar jetën dhe shëndetin e personalitetit apo shkatërrimin e pronës (objektit në ruajtje).

Grumbullimi i informacionit kriminal është elementi kyç i sigurisë, i cili ndikon drejtpërdrejtë në suksesin e institucionit në luftën kundër krimit në adresim të personaliteteve apo objekteve në ruajtje. Sektori i analizës, në bashkëpunim me shërbimet partnere në vend të luftës kundër veprave terroriste apo dhe krimeve të rënda në fokus të cilave janë personalitetet e larta shtetërore, synohet të hartojë plane bashkëpunimi për koordinimin e veprimeve dhe ndjekjen e procedurave për sigurimin e informacionit, për të mësuar se çfarë po ndodh realisht nga elementi me tendencë që dëmtojnë jetën dhe shëndetin e personalitetit, në funksion të parandalimit të krimit të këtij lloji.

Orientimi i veprimtarisë së strukturave të Gardës do të drejtohet kundrejt marrjes së informacionit. Prioritet në këtë drejtim mbetet krijimi i infrastrukturës së nevojshme për një menaxhim të integruar të të gjithë informacionit kriminal për këto lloj tendencash. Për t'u kuptuar e zbatuar ky model, është e nevojshme që në të ardhmen të rriten aftësitë e punonjësve nëpërmjet realizimit të trajnimeve specifike mbi inteligjencën.

Për zbatimin e këtij prioriteti lind si domosdoshmëri identifikimi i zonave më problematike të krimit, identifikimi i detajuar i subjekteve me tendenca për veprimtari terroriste apo dhe krime kundër jetës dhe shëndetit të personalitetit.

Një tjetër prioritet ka të bëjë me *përmirësimin e kapaciteteve së Sallës Operative*, e cila që prej vitit 2020, me miratimin e strukturës së re organike, ka një peshë tjetër në rang të përgjithshëm institucional si një strukturë autonome në varësi të Komandantit të Gardës.

Sa i përket parandalimit të rreziqeve të mundshme që vijnë në drejtim të personaliteteve nga lëndët eksplozive dhe armët e shpërthimit në masë, një objektiv në këtë drejtim do të ishte *përmirësimi i kapaciteteve të teknologjisë për zbulimin dhe parandalimin e incidenteve me LE&ASHM*. Pajisja me aparatura moderne e të kohës, duke siguruar kushte normale pune e jetese për PLSH-te dhe administratën në ORV, është prioritet kryesor për këtë sektor, jo më pak të rëndësishëm në Gardë. Rritja e cilësisë së njohurive të specialistëve, nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve për përdorimin me kapacitet te plotë të aparaturave në realizimin e detyrave, pajisja me mjete transporti për personelin, qentë eksplozivë – kërkues dhe aparaturave me kapacitete normale lëvizëse në zbatimin e detyrave do të ishte një vlerë e shtuar në përmirësimin e sigurisë së personaliteteve dhe objekteve në ruajtje.

Me qëllim që cilësia e shërbimit të të gjitha strukturave operacionale të arrijë nivelet e kërkuara, është gjithashtu e nevojshme *zhvillimi i trajnimeve dhe stërvitjeve* të shtuara dhe më të specializuara në fushën e sigurisë.

Qëllimi i këtij objektiv është që të ndryshojë cilësisht e gjithë veprimtaria për përgatitjen e kualifikimin e punonjësve, e cila do të reflektohet tek rritja e standardeve të shërbimit të sigurisë. Realizimi i objektivit kërkon që mbi bazën e studimit, të punohet me program të veçantë pune, për të zhvilluar politika të studiuara në funksion të nevojave aktuale dhe atyre të perspektivës së shërbimit të Gardës. Për të ndryshuar cilësisht trajnimin dhe kualifikimin e punonjësve, vëmendja do të përqendrohet në:

- Vijimin e bashkëpunimit me Institucionin arsimor të Policisë së Shtetit për përgatitjen dhe kualifikimin e punonjësve të Gardës, për të gjitha nivelet e shërbimit dhe në mënyrë të vazhdueshme. Kjo kërkon të rikonceptohet infrastruktura ligjore e Gardës, organizative dhe ajo mësimore.

- Rivlerësimin e programeve mësimore ekzistuese dhe ndërtimin e programeve e kurrikulave të reja, për nivelet e ndryshme të punonjësve, si dhe shërbimet e specialiteteve të veçanta.
- Rivlerësimin me objektivitet të personelit të Gardës ekzistues të të gjitha niveleve e shërbimeve, të cilët janë me arsim e trajnime nga shkolla, periudha e programe të ndryshme, duke përdorur programe të veçanta që u përshtaten legjislacionit ekzistues, përgjegjësi, gradave dhe funksioneve që mbulojnë.
- Dhënien prioritet formimit të punonjësve të rinj të shërbimit të sigurisë, si dhe rekrutimit të shtetasve me arsim të lartë, duke përfunduar kriteret, procedurat dhe transparencën e konkurrimit.
- Qëllimi është që të ulet mosha mesatare në Gardë, sidomos në shërbime kyçe siç janë ato të sigurisë fizike të personaliteteve, të rritet pjesëmarrja e grave, si dhe të rinovohet personeli i shërbimeve të veçanta me punonjës që kanë arsimin e kualifikimin e duhur në fushat respektive.

Qendra e Formimit dhe kualifikimit Profesional në Gardë, si strukturë e rëndësishme dhe përgjegjëse për kualifikimin fillestar dhe zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale të punonjësve duhet të përmbushë këto objektiva:

- Në programin e përgjithshëm të trajnimeve, duhet të përfshihen edhe strukturat mbështetëse, pavarësisht lektorëve dhe ambientit ku do të zhvillohen. Për çdo grupim dhe program duhen të përgatiten dhe miratohen modulet përkatëse, qysh në fillim të vitit.
- Përmirësimi i aftësive pedagogjike të stafit mësimdhënës, i cili kërkon rritjen e kapaciteteve të tyre në përshtatje me përvojën e institucioneve të sigurisë së rendit publik dhe sigurisë kombëtare dhe ato operacionale në Gardën e Republikës.

Shërbimet mbështetëse, vlerësohen si shumë të rëndësishme për arritjen e suksesit nga strukturat operacionale.

Produktiviteti i burimeve njerëzore nuk mund të qëndrojë me vete pa një mbështetje të burimeve të tjera logjistike siç janë uniformat, pajisjet, mjetet, armatimi, shërbimi i ushqimit, mjediset, infrastruktura, etj. Është e domosdoshme kompletimi me mjete e pajisje bashkëkohore për përmbushjen e misionit në mënyrë që të arrihen standardet e shërbimeve homologe Europiane. Gjithashtu, burimet mbështetëse luajnë një rol vendimtar në imazhin e Gardës, në raport me mjedisin e jashtëm.

Përmirësimi i kushteve të punës dhe teknologjisë si një kusht, pa të cilin nuk mund të përmbushen detyrat e shërbimit të Gardës për ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve dhe objekteve. Eksperiencia e viteve të fundit për ndryshimin e kushteve të punës dhe trajtimin e denjë financiar të punonjësve, tregon qartë se sa efekt kanë ato në ndryshimin e treguesve cilësorë të shërbimit dhe në përgjithësi të standardeve të sigurisë. Përmirësimi i burimeve mbështetëse dhe i menaxhimit të tyre, do vazhdojë të jetë objektiv prioritar për drejtimin e Gardës, sepse nga niveli dhe efektiviteti i tij varet në masë të konsiderueshme edhe performanca e shërbimit të sigurisë.

Ai do të synojë në përmirësimin e standardeve të:

- ✓ kushteve të punës, akomodimit në ambiente të përshtatshme për shërbime;
- ✓ shërbimeve logjistike;
- ✓ sistemit të menaxhimit financiar.

Realizimi i këtij objektivi, kërkon përgatitjen e projekteve konkrete për njësi, shërbime, procese pune të veçanta, pajisje, programime, teknologji etj., për të cilat është e nevojshme të riorganizohet struktura e veçantë, duke u plotësuar me specialistë të kualifikuar në këtë drejtim, për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të zhvillimit që ka Garda. Në ndryshim nga tradita e mëparshme, ku mbështetja me burimet financiare ka qenë e pjesshme, miratimi i VKM-ve për përmirësimin e trajtimit financiar të punonjësve ka qenë një objektivi i realizuar në drejtim të motivimit dhe vlerësimit të rolit të punonjësit të Gardës. Përpos kësaj, realizimi i objektivave për ndryshimin e standardeve të Gardës dhe sigurisë gjatë këtij dhjetëvjeçari, kërkon bërjen e investimeve prioritare nga institucionet shtetërore përgjegjëse.

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit, përmirësimi i IT-së dhe rrjeteve të komunikimit, nëpërmjet informatizimit të proceseve të punës dhe të mbështetjes me teknologji të reja, është kusht pa të cilin nuk mund të ndryshojnë standardet e shërbimit të sigurisë. Strategjia e zhvillimit të sistemeve të komunikimit në Gardën e Republikës është e mbështetur në misionin e Gardës, nevojës dhe kërkesës sfiduese të strukturave të Gardës për t'ju përgjigjur sfidave të sigurisë në një mjedis të ndryshuar sigurie. Strategjia e zhvillimit 2020 -2030 është e detyruar të vlerësojë si një nga shtyllat e saj, sigurinë e informacionit, shkëmbimin e informacionit dhe për më tepër administrimin e tij në sistemet e komunikimit.

Garda e Republikës si një strukturë me impakt në sigurinë Kombëtare, duhet t'i përgjigjet sfidave të sigurisë duke analizuar faktorët që e prishin këtë mjedis, në mënyrë që kapacitetet operacionale që projektojmë dhe do të ndërtojmë në një periudhë afatgjatë 2020 – 2030, t'i shërbejnë procesit të mbështetjes Komandim - Kontrollit dhe përmbushjes së misionit. Është mëse e dukshme dhe e analizuar nga shumë agjenci të tjera sigurie të vendit dhe të vendeve partnere, se impakti i Teknologjisë së Informacionit në mjedisin e sigurisë është faktori më i rëndësishëm, ndaj dhe është vlerësuar që për periudhën e kërkuar të zhvillohemi në dy drejtime:

- ✓ Zhvillimin e sistemeve të sigurisë dhe vëzhgimet me kamera
- ✓ Ndërtimi i Sallës së Serverave dhe rrjetit kompjuterik të klasifikuar.

A. Ndërtimi i sistemeve të sigurisë dhe vëzhgimit me kamera ORV dhe objekte të tjera do t'i shërbejë zhvillimit dhe përmirësimit të sigurisë në ORV. Duke forcuar kapacitetet operacionale në këtë drejtim do të krijohen mundësitë:

1. Për të marrë dhe administruar të dhëna në çdo kohë për ORV (për regjimin e hyrjes- daljes së mjeteve, personelit sipas Aksesit dhe zonave të sigurisë, vendosim perimetër kontroll të objekteve dhe alarmet përkatëse, alarmet ndaj zjarrit, ujit etj.)
2. Të dhënat ruhen në dy nivele
 - a) Në Serverat e Gardës
 - b) Në çdo ORV
3. Të dhënat që merren në çdo objekt, do të ruhen dhe administrohen në bazë të ligjit për sigurinë e informacionit të klasifikuar, nën një infrastrukturë që çertifikohet si e sigurtë nga DSIK.
4. Objektet monitorohen 24 orë në 24 në dy nivele
 - a) Në qendrën integrale të monitorimit në Gardën e Republikës,
 - b) Në Qendrën monitoruese të çdo ORV.
5. Shërbimet mund të kryhen me grupe të gatshme në çdo ORV duke ulur prezencën e shërbimit roje.
6. Përmirësimi i kushteve të shërbimit për punonjësit duke i bërë shërbimet e Gardës më atraktive për burimet njerëzore që do të shërbejnë në perspektivë.

Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemeve të sigurisë në ORV për periudhën 2020 – 2030 është faktori kryesor që kontribuon në cilësinë e treguesve operacionalë të strukturave të Gardës në përmbushje të misionit të saj, si dhe do t'i lejojë dhe krijojë mundësi Komandatit të Gardës të njohë në kohë reale situatën në objekte sipas gjendjes dhe situatës së sigurisë, ta ushqejë atë me informacione e duhur, për të vlerësuar e analizuar riskun në shërbim të vendimarrjes.

B. Ndërtimi i Sallës së Serverave dhe rrjetit kompjuterik të klasifikuar


Ndërtimi i i Sallës së Serverave të Gardës së Republikës për periudhën 2020 – 2030 kërkon të zhvillojmë në ritmet e duhura kapacitete të menaxhimit të informacionit, të të dhënave që vijnë dhe punohen si në rrjetin e brendshëm të Gardës por dhe rrjeteve të tjera në të cilat infrastruktura jonë integrohet në interes të misionit.

Kapacitetet që ndërtohen në sallën e serverave, parashikojnë instalimin deri 10 (dhjetë) Rack të dedikuar:

- a) Për programimin dhe administrimin e burimeve njerëzore nga momenti i pranimit në strukturat e Gardës deri në largimin e këtij personeli nga kjo strukturë.
- b) Për administrimin e aseteve dhe vlerave financiare e materiale.
- c) Ndërtimin e rrjetit të klasifikuar për administrimin e informacionit konfidencial, Sekret, Tepër Sekret, sipas nivele të sigurisë. Ky rrjet do të çertifikohet si i sigurtë nga institucionet që japin çertifikatën e sigurisë së rrjetit dhe personelit që e administrojnë dhe e përdorin.
- d) Dixhitalizimi i arkivave të Gardës.
- e) Të dhënat që krijohen dhe administrohen, do të jenë parashikuara të ruhen në dy nivele duke mos rrezikuar asnjëherë integritetin dhe sigurinë e tyre.

Zhvillimet në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, kërkojnë të përgatitet mjedisi për zhvillimin e burimeve njerëzore të IT, si personel administrator por të edukohet edhe personeli përdorues duke hequr dorë nga format e tejkaluara të komunikimit duke u përshtatur me tendencën imponuese të mjeteve të komunikimit.

I gjithë zhvillimi që parashikohet në drejtim të IT, do të lindë si nevojë përmirësime ligjore, hartimin e rregulloreve dhe udhëzimeve të duhura për të standardizuar procedurat dhe protokollet e rrjeteve, sigurisë së informacionit duke krijuar një mjedis të sigurtë komunikimi.



Strategjia e zhvillimit të Gardës përfshin edhe atë të zhvillimit të sektorit të armatimit, i cili mbështet atë si strukturë e armatosur që të përmbushë misionin.

Për periudhën e mësipërme të zhvillohemi në dy drejtime:

- ✓ Modernizimin i armatimit sipas standarteve të BE
- ✓ Pajisja me mjete mbrojtëse

Për përmbushjen me sukses të misionit dhe detyrave të ngarkuara, strukturat e Gardës kanë nevojë të pajisen me armatime dhe pajisje të tjera që janë të ndërveprueshme me ato që disponojnë vendet partnere dhe anëtare të Bashkimit Europian. Modernizimi i armatimit dhe pajisjeve perbën një nga drejtimet e rëndësishme të modernizimit të përgjithshëm të strukturave të Gardës.

II. NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS LIGJORE PËR PËRAFRIMIN E GARDËS ME STRUKTURA HOMOLOGE

Si domosdoshmëri e kohës lind ndërtimi i infrastrukturës ligjore në mënyrë të tillë që Garda të përafrohet me strukturat e saj homologe. Qëllimi i miratimit të infrastrukturës së re ligjore është përmirësimi i veprimtarisë së Gardës së Republikës, riorganizimin në tërësi të saj, duke forcuar statusin, misionin, profesionalizmin, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe efikasitetin.

Objektivat që synohen të arrihen me miratimin e infrastrukturës së re ligjore janë:

- ✓ përcaktimi me ligj të veçantë dhe të integruar i organizimit dhe funksionimit të Gardës së Republikës dhe i sistemit të gradave e karrierës së punonjësit të këtij institucioni;
- ✓ përcaktimi i qartë i autoriteteve dhe kompetencave të tyre;
- ✓ përcaktimi më i plotë i veprimtarisë së Gardës së Republikës;
- ✓ përcaktimi me ligj i kriterëve të emërimit dhe të lirimit të Drejtorit e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm;
- ✓ përcaktimi në ligj i kriterëve të përgjithshme dhe i kriterëve të veçanta të pranimit të punonjësve;
- ✓ përcaktimi i autoriteteve përkatëse për nxjerrjen e akteve nënligjore, në veçanti duke ndarë përcaktimin e rregullave të brendshme të organizimit të Gardës nga Drejtuesi i Gardës dhe i Rregullores së Gardës së Republikës, që përfshin dispozitat mbi personelin dhe disiplinën, pajisjet, mjetet, armatimi me vendim të Këshillit të Ministrave;
- ✓ qasjen e përafërt me Policinë e Shtetit për sa i përket sistemit të gradave, arsimimit, marrëdhënieve të punës. Zëvendësimi i sistemit aktual të gradave ushtarake me ato policore sjell rifreskim të termave dhe vetë statusit që mbart institucioni.

Periudha mbi pesëmbëdhjetëvjeçare që ka kaluar nga ligji i cili aktualisht është në fuqi dhe problematikat që ka diktuar dinamika e punës, kanë bërë të nevojshëm hartimin e këtij projektligji, me synim për t'ia përshtatur situatës aktuale.

Ligji nr. 8869, datë 22.05.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është miratuar në një kohë, ku siguria e Personaliteteve realizohej edhe nga ushtarë të shërbimit të detyrueshëm dhe rrjedhimisht struktura, përbërja organike dhe gradat, mbartin terma që i përkasin strukturave të Forcave të Armatosura.

Gjithashtu, nevoja e kësaj nisme legislative është diktuar edhe në prioritetet e Ministrisë së Brendshme, konkretisht në përmbushje të prioritetit për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, forcimin e rendit dhe sigurisë publike, ka lindur domosdoshmëria e reformimit të kuadrit ligjor për Gardën e Republikës, duke përcaktuar kështu në mënyrë më të qartë e më të plotë detyrat dhe përgjegjësitë e këtij shërbimi.

Ndër të tjera, nevoja e miratimit të një ligji organik të veçantë për Gardën e Republikës rrjedh pasi:

- ✓ Ky institucion ofron siguri më të lartë e më të specializuar për Personalitetet e Larta Shtetërore të vendit dhe ato homologe të shteteve të tjera, gjatë qëndrimit të tyre në

Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, siguron edhe Personalitete të tjera shtetërore që për shkak të misionit dhe funksioneve të tyre klasifikohen si të tillë.

- ✓ Organizimi, funksionimi, formimi profesional, kriteret e pranimit, detyrat dhe përgjegjësitë e Gardës janë specifike dhe të ndryshme nga ato të strukturave të tjera të sigurisë në Ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.
- ✓ Struktura të tjera të fushës së sigurisë si: Policia e Shtetit, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimi Informativ Shtetëror, Agjencia e Inteligjencës së Sigurisë e Mbrojtjes, Policia e Burgjeve, etj, Policia për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, funksionojnë me ligje organike të veçanta.

III. PËRMIRËSIMI I POLITIKAVE TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Perspektiva e menaxhimit të burimeve njerëzore ka në optikën e vet rikonceptimin tërësor të metodave dhe masave konkrete për rritjen e profesionalizmit të punonjësve dhe performacës së institucionit. E parë në këtë këndvështrim projeksioni i zhvillimit të burimeve njerëzore do të ketë si udhërefyes politikat dhe masat e planizuara për tu realizuar nga Ministria e Brendshme në këtë fushë.

Drejtimi kryesor i kësaj strategjie do të jetë “Menaxhimi i Ciklit Jetësor të të punësuarve”.

Koncepti i menaxhimit të ciklit jetësor të burimeve njerëzore është metoda me të cilën do të menaxhohet personeli i Gardës së Republikës së Shqipërisë. Proceset e ciklit jetësor të burimeve njerëzore do të drejtohen në mënyrë të centralizuar dhe do të zbatohen në mënyrë të decentralizuar, duke ndërmarrë hapat e nevojshme për përmirësimet ligjore e nënligjore. Menaxhimi i ciklit jetësor përbëhet nga shtatë pjesë të cilat janë vetëvepruese, por në të njëjtën kohë edhe ndërvepruese me njëra-tjetrën. Çdo veprim në njërin nga pjesët e ciklit jetësor, sjell rrjedhime në një ose më shumë pjesë të tjera. Ky sistem kompleks kërkon personel menaxhues, të cilët duhet të kenë njohuri dhe përvojë në menaxhimin e këtij cikli.

Pjesët përbërëse të ciklit jetësor të burimeve njerëzore janë:

- rekrutimi,
- arsimimi/trajnimi,
- zhvillimi,
- mbështetja

Të gjitha pjesët e ciklit jetësor të burimeve njerëzore do të zhvillohen e përmirësohen duke u përqëndruar në këta objektiva kryesorë:

- a. Rikonceptimi i sistemit të rekrutimit, qëndrimit në detyrë dhe promovimit, bazuar në sistemin e meritokracisë, vlerësimin objektiv e të qëndrueshëm si dhe trajnimin e vazhdueshëm profesional;
- b. Transformimi i metodologjisë së arsimimit në bashkëpunim me Akademinë e Policisë dhe atij trajnues në strukturat tona, për të siguruar programe të integrueshme dhe gjithëpërfshirëse, të cilat do të përgatitin kandidatët për oficerë në Gardë, si dhe të gjithë personelin për specialitetet e nevojshme;
- c. Sigurimi i një sistemi të drejtë, transparent dhe të barabartë për menaxhimin e karrierës lidhur me emërimin, vlerësimin dhe ecurinë në gradë e karrierë;
- d. Krijimin e një sistemi të automatizuar informacioni të menaxhimit të burimeve njerëzore, i cili të përdoret për të menaxhuar punonjësit në të gjitha nivelet.

Rikonceptimi i sistemit të rekrutimit , qëndrimit në detyrë dhe promovimit, bazuar në sistemin e meritokracisë, vlerësimin objektiv e të qëndrueshëm si dhe trajnimin e vazhdueshëm profesional

Rekrutimi

Me qëllim rikonceptimin tërësor të sistemit të rekrutimit mbështetur në kërkesat e kohës dhe ndërtimin e një sistemi transparent të rekrutimit dhe qëndrimit në detyrë kemi hartuar kritere më korrekte dhe në koherencë me programin e Ministrisë së Brendshme në këtë drejtim të cilat bazohen në parimet e meritokracisë dhe transparencës.

Verifikimi i garantimit të integritetit dhe të kushtit të sigurisë është një risi që synojmë të integrojmë, e cila zbatohet ndaj personit që kërkon të punësohet në Gardën e Republikës, si dhe për lidhjet e tij me personat e familjes ose jashtë saj. Personat që nuk rezultojnë me integritet të pastër dhe nuk plotësojnë kushtin e sigurisë nuk pranohen apo ripranohen në Gardën e Republikës.

Gjithashtu, Sektori i Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me strukturat e tjera të Gardës, për disa funksione të veçanta si grupet e shoqërimit të PLSH, të vendit dhe të huaja, asistuesit e PLSH, kryen verifikime periodike për personalitetin e tyre, si dhe për implikimet e tyre në veprimtari të jashtëligjshme.

Në procesin e rekrutimit të punonjësve të rinj do të mbahet parasysh një raport i drejtë ndërmjet kërkesave, meritave dhe pastërtisë së figurës së aplikantëve.

Vlerësimi vjetor i punonjësit të Gardës

Punonjësi i Gardës çdo vit pune duhet t'i nënshtrohet testeve vjetore, vlerësimeve të punës dhe integritetit. Vlerësimi vjetor dhe ai periodik në strukturat e Gardës së Republikës do të bëhet bazuar në tregues të performancës, integritetit dhe përgatitjes profesionale të punonjësve. Modelet e vlerësimit kanë pësuar ndryshime në vite duke ju përgjigjur kërkesave të kohës. Modeli aktual i formularit të vlerësimit është hartuar duke u konsultuar me përvojat më të mira të shërbimeve homologe në vendet e zhvilluara.

IV. KRIJIMI I NJË KULTURE MODERNE MENAXHIMI

Ndryshimet shoqërore të këtyre viteve janë reflektuar edhe në mënyrën e menaxhimit të Gardës, por ende nuk është krijuar një kulturë bashkëkohore dhe e vetme menaxhimi. E theksojmë këtë duke u nisur nga disa mangësi të evidentuara në drejtim të menaxhimit të veprimtarive. Përveç mangësive të analizuar gjatë dinamikës së punës e veprimtarive, si problem të rëndësishëm vlerësojmë mungesën e promovimit të vlerave më të mira, duke mos krijuar standarde për motivimin e individëve që mbartin këto vlera. Lidhshipi i çdo strukture apo shërbimi luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e strukturës, e lidhur kjo jo vetëm me ekzistencën e një vizioni të qartë por edhe me aplikimin e formave dhe metodave që do të ndikonin në krijimin e kulturës menaxheriale.

Pavarësisht veprimtarive që mund të ketë një strukturë, mosmenaxhimi i duhur i tyre do të sillte mosarritjen e suksesit të strukturës. Në përvojën e deritanishme të veprimtarisë së Gardës, në periudha të ndryshme, janë vënë re mangësi të shkaktuara nga ekzistenca e faktorëve të tillë si:

- mungesa e qëllimeve,
- mungesa e një stafi profesional,
- mungesa e trajnimeve në disa struktura dhe funksione të veçanta.

Me anën e përsosjes së menaxhimit të brendshëm në Gardë, synohet që të ndryshojë niveli i menaxhimit e drejtimit brenda institucionit, nëpërmjet njohjes e respektimit të rregullores së brendshme e akteve të tjera normative, si dhe zhvillimit të procesit të planifikimit, organizimit, drejtimit e kontrollit, i cili do të japë impaktin e vet në realizimin e detyrave. Përmirësimi i standardeve në funksionimin e brendshëm, shtron nevojën e:

- ✓ menaxhimit të planifikuar të burimeve njerëzore dhe burimeve të tjera;
- ✓ përdorimit të procedurave standarde të matjes së performancës;
- ✓ plotësimin të të drejtave të punonjësve të përcaktuara në ligj.

Forcimi i menaxhimit në Gardë kërkon, gjithashtu, ndryshim të stilit të drejtimit nga drejtuesit, të cilët duhet të kthejnë fytyrën e kujdesin për punonjësit dhe trajtimin e tyre, që të marrin produktin e planifikuar dhe të rritin rezultatet e shërbimit. Drejtimit në Gardë i duhet të ndryshojë mënyrën e komunikimit me punonjësit dhe të vendimmarrjes, për t'i njohur me objektivat e detyrat, si dhe për t'i përfshirë ata në diskutimin e zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë shërbimet e sigurisë.

Objekti do të arrihet duke rikonsideruar të gjitha elementet e organizimit dhe të funksionimit të brendshëm, e veçanërisht:

- Planifikimin, i cili ka të bëjë me përdorimin dhe harmonizimin e të gjitha burimeve, sidomos atyre njerëzore në funksion të qëllimit dhe rritjes së efektshmërisë.
- Organizimin e shërbimeve, të cilat duhet t'u përgjigjen faktorëve të mjedisit, në kohën më të shpejtë dhe në mënyrë profesionale në fushën e sigurisë dhe përmbushje të misionit.

- Drejtimin, i cili duhet të ndryshojë për të motivuar nëpërmjet stilit të drejtimit dhe shembullit personal, në të gjitha nivelet e strukturave. Në mënyrë të veçantë duhet të ndryshojë vendimmarrja për zbatimin e politikave në zhvillimin e karrierës e cila duhet të kthejë besimin brenda Gardës dhe shndërrohet në instrument motivues.
- Kontrollin, i cili duhet të organizohet e të funksionojë më mirë:
 - a) Brenda Gardës sipas niveleve e strukturave, duke shmangur familjarizimin, indiferencën dhe mbulimin e defekteve e shkeljeve;
 - b) Nga struktura e burimeve njerëzore, e cila duhet të ndjekë procedurat me objektivitet, për të parandaluar keqsjelljet, abuzimet e ndryshme në detyrë, shkeljet e të drejtave të njeriut, rastet korruptive etj.;
 - c) Duke bashkëpunuar me struktura të tjera ligjzbatuese dhe kontrolluese brenda Ministrisë së Brendshme, për të njohur faktorët e shkaqet dhe parandaluar në kohë shkeljet ligjore e administrative në përgjithësi;

Që të krijohet një kulturë bashkëkohore menaxhimi brenda strukturës është i nevojshëm edhe ndryshimi i mentalitetit të mjedisit të brendshëm të saj, e mishëruar kjo dhe me ndryshimin e mendësisë së individëve, i cili do të sillte një mjedis të brendshëm të hapur drejt ndryshimeve, koncepteve të reja si dhe do të përfronte këtë mjedis me standardet e shërbimeve homologe perëndimore.

KAPITULLI IV

BUXHETI

Në dokumentin strategjik të Politikave egzistuese përshkrimi i politikës së programit Garda e Republikës konsiston në: Ruajtja e Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe familjet e tyre, personalitetet e larta të këtij rangu që vizitojnë vendin tonë, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Z/Kryetarët e Kuvendit, Anëtarët e KM, Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Kryetarit të KLSH, Guvernatorit të Bankës, Avokatit të Popullit, Kryetarit të KQZ-së, Kryetarit të Maxhorancës, Kryetarit të Partisë më të madhe të Opozitës Parlamentare, Kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe familjet, selitë dhe rezidencat qeveritare.

Qëllimi i Politikës së Programit është: Të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standardet gjermane në fushën e sigurisë.

Programi Garda e Republikës ka një objektiv të vetëm që është Rritja e nivelit të sigurisë të Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe Objekteve të Rëndësisë së Veçantë dhe në funksion të këtij objektivi ka identifikuar dy tregues performance që janë:

- Numri i rasteve të shkeljes së sigurisë ndaj numrit total të rasteve
- % e femrave gardiste ndaj totalit

Treguesi i parë i performancës matet me përqindje në trendin ulës, ndërsa treguesi i dytë i performancës matet po me përqindje por në trendin rritës.

Produktet e Programit Garda e Republikës janë Personalitetet VIP vendas dhe të huaj të ruajtur nga Garda si dhe produktet që kanë të bëjnë me modernizimin e infrastrukturës në përdorim që ka ky program të cilët po i listojmë më poshtë, të shoqëruar me kostot përkatëse që priten ti shoqërojnë këto produkte deri në vitin 2030.

- Blerje Mjete Transporti në vlerën 777.500.000 lekë.
- Rikonstruksion i Vilave të OKV Dajt në vlerën 93.378.000 lekë.
- Rikonstruksion Godine Garda Republikës, Sektori Ruajtjes Rezidencave, Vlorë në vlerën 19.000.000 lekë.
- Rikonstruksion Godine Garda Republikës, Sektori Ruajtjes Rezidencave Durrës në vlerën 38.979.000 lekë.
- Rikonstruksion Godine Garda Republikës, Sektori Ruajtjes OKV Dajt në vlerën 29.270.000 lekë.
- Rikonstruksion i ambienteve të Qendrës së Formimit e Kualifikimit Profesional, të Gardës Republikës, Mullet në vlerën 241.051.000 lekë.
- Blerje pajisje, orendi zyre në vlerën 27.000.000 lekë.
- Ndërtimi i dhomës së Serverave, dhe zhvillimi i rrjetit të brendshëm kompjuterik të klasifikuar sipas standardeve të sigurisë në vlerën 84.000.000 lekë.
- Ndërtimi dhe integrimi i sistemeve të sigurisë dhe vëzhgimit me Kamera për ORV dhe infrastrukturën e Gardës së Republikës në vlerën 150.000.000 lekë.
- Modernizimi i shërbimit të stërvitjes në vlerën 1.133.250.000 lekë.
- Modernizimi i Sektorit të Ruajtjes nga Incidentet me LE dhe ASHM”, në vlerën 75.000.000 lekë.
- Blerje armatimi për Gardën e Republikës në vlerën 230.000.000 lekë.

KAPITULLI V

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Kjo strategjitë 10-vjeçare si një risi e këtij dokumenti, do të sjellë forcimin e autoritetit të institucionit dhe të kapaciteteve në drejtimin afatgjatë të Gardës. Këto plane duhet të kontribuojnë në përmbushjen e prioriteteve duke reflektuar në rrethana e nevoja dhe gjithmonë duke u përfshirë në konsultime. Një ndër arsytet e afatit 10- vjeçar të këtij dokumenti është dhe domosdoshmëria e

politikave afatgjata lidhur me investimet në fushën e aseteve në përdorim nga Garda e Republikës. Nisur nga gjendja aktuale e ndërtesave si dhe investimet e kryera, ende mbetet shumë për t'u bërë jo vetëm në lidhje me rikonstrukcionin dhe përafrimin e tyre me standardet bashkëkohore por dhe me përmirësimin e procedurave të administrimit.

Planifikimi në Gardë dhe në strukturat në varësi të saj do të bazohet në strategjinë afatgjatë të zhvillimit, duke zërthyer në plane të nivelit taktik e operacional, prioritetet dhe objektivat e përcaktuar në përshtatje dhe me kushtet konkrete e veçoritë e shërbimeve.

Përgjegjësia për realizimin e kësaj strategjie është e Gardës së Republikës. Lidhur ngushtë me planifikimin është kompletimi i burimeve të nevojshme që duhen për të realizuar detyrat e ngarkuara. Kjo kërkon planifikim të saktë, për:

- ✓ sigurimin e personelit të Gardës, me standardet e duhura profesionale;
- ✓ kompletimin e mjediseve, kushteve të punës dhe teknikës së shërbimit;
- ✓ sigurimin e buxhetit të nevojshëm, për të plotësuar të drejtat e punonjësve dhe nevojat e tyre.

Ndryshimet në legjislacion, organizim, përgjegjësi etj., do të prezantohen me kujdes e përcillen në të gjitha nivelet e drejtimit e punonjësit e Gardës, duke punuar në mënyrë graduale, dhe më pas duke përshpejtuar ritmin e ndryshimeve për realizimin e objektivave. Menaxhimi i nivelit të lartë gjatë zbatimit të kësaj strategjie do të ndjekë me vëmendje vështirësitë, pengesat dhe shkaqet e rezistencës, dhe do të marrë masa për shmangien e tyre. Monitorimi i Strategjisë së Gardës së Republikës, bazohet në detyrimet që përcakton ligji “Për Gardën e Republikës,, dhe Rregullorja e Brendshme e saj. Për ndjekjen nga afër të realizimit të objektivave strategjike dhe harmonizimin e masave midis strukturave duhet të përqendrojë vëmendjen e saj Drejtoria e Planifikimit, Koordinimit dhe Kontrollit, e cila duhet të informojë Komandantin e Gardës për ecurinë e zbatimit dhe problemet që kërkojnë zgjidhje. Institucioni përgjegjës për vlerësimin e zbatimit të kësaj strategjie është Ministri i Brendshëm, i cili ndjek në vijimësi realizimin e objektivave dhe performancës në tërësi apo problemeve të veçanta dhe njëherësh përcakton objektiva të tjerë për Gardën e Republikës.

Për të monitoruar zbatimin e strategjisë do të shfrytëzohen të dhënat e administruara në statistikat zyrtare të DPKK në Gardën e Republikës, në analizat mujore e vjetore dhe në raportet e ndryshme periodike.

Njëkohësisht, zbatimi i kësaj strategjie duhet të ndjekë dhe të sinkronizohet me strategjinë në nivel Ministrie apo për sigurinë kombëtare.

Nëntor 2020

